

# SHQIPTARËT E HOUSTON-IT FESTUAN



Këta fëmijë nuk do ta harrojnë Festën e Flamurit. Ata kalojnë dorë më dorë gazetën Illyria, gazetën që u mbanë gjallë gjuhën shqipe



Pamje nga darka që u shtrua me rastin e Ditës së Pavarësisë, Ditës së Flamurit Kombëtar

## NGA GJEKË MARINAJ

Këtë vit, shqiptarët e Houston-it e festuan me aq krenari dhe madhësi festën e Flamurit, sa që jo vetëm personeli, por edhe klientët e hotelit "Crowne Plaza," pyesnin njëri tjetrin me çudi për të veçantën që fshihej pas datës së 28 Nëntorit. Fredericko Bariantes, 16-vjeç, i cili kishte ardhur me familjen e tij nga Colorado-ja për të vizituar qytetin "NASA," siç e quante ai Houston-in, i entuziazmuar nga atmosfera festive, kishte manipuluar frazën e njohur të astronomëve të Apollo 13 nga "Houston, we've got a problem," në "Houston we've got eagles." Ai e përsëriste dhe e ripërsëriste çiltërsisht me të motrën, Epifania, këtë frazë tek shikonin së bashku nga dera spektaklin e vërtet të këtij festimi.

E si mund t'u veje faj këtyre dy të rinjve, kur shqiponja dykrenore e Flamurit tonë kombëtar, gjendej e stampuar në çdo tullumbace, në çdo flamur dhe në çdo simbol tjetër dekorues që kishin mbushur plot e përplot sallën e kryesore të hotelit, e cila kishte një kapacitet prej rreth 200 vendesh.

Vangjel Bojaxhi, i cili fliste me gjuhën e një intelektualit të formuar, vlerësoi se "Festa e Flamurit është një eveniment vërtet i rëndësishëm, sepse një komb që nuk feston festën e flamurit të vet, është vështirë të pretendojë për diçka më të madhe." Ai e kishte fjalën për "diçka më të madhe" si ç'ishte vizioni i tij për një komunitet shqiptar me një unitet global, pa nevojën e fraksioneve dhe shoqatave shqiptare—të pafuqishme për të bërë ndryshimet që ka nevojë të bëjë kombi ynë.

Bojaxhi me të drejtë e gjente shpresën e këtij uniteti mbarëshqiptarë tek forca bashkuese e Flamurit: "Pranë Flamurit tonë krijohet identiteti, njohja, dhe rritja e vlerave kombëtare për secilin prej nesh," përfundoi ai.

Vetëm Flamuri dhe dita e tij e kanë forcën për të gjeneruar një energji të tillë besimi dhe mirënjohje midis shqiptarëve kudo që janë. Respekti dhe dashuria dukej qartë edhe në përshëndetjet midis tyre: "Gëzuar Festën e Flamurit!" uronin duke u ngritur në këmbë për t'i shtrënguar dorën njëri-tjetrit.

Natyrisht, një mbrëmje kaq e këndshme nuk mund të ndodhte vetvetiu. Pjesëmarrësit ia dedikonin qejfin që po bënin kryesisht së Shoqatës Arbëria, ku ata bënin pjesë. Me të drejtë, se kryesia kishte menduar për gjërat e vogla dhe të mëdha të këtij eventi. Shumë fëmijë tërhiqnin prindërit t tyre përdore për të bërë fotografi. Ata e kishin parë se në një kënd të sallës ishin vendosur mjetet e nevojshme për të bërë fotografi të nivelit profesional.

Adem Sanxhaku e tha me pak fjalë strategjinë e kryesisht së shoqatës për t'ua bërë sa më tërheqëse ditën e flamurit fëmijëve: "Ne e kemi detyrë të luajmë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e jetës dhe të veprimtarisë së komunitetit shqiptar të Houston-it. Sidomos përcjellja e vlerave kombëtare për tek brezi i ri, pra për tek fëmijët tanë, do të mbetet një përpjekje e përhershme."

Dr. Xhemal Kaçuli s'kishte si të ishte më dakord me Sanxhakun. Ai e cilësonte si pikën më të rëndësishme edukimin e të rinjve me virtytet patriotike shqiptare, me vlerat e gjuhës, kulturës dhe traditave të kombit tonë. "Unë e shoh shoqatën Arbëria si tabanin kryesor, ku mund të rriten dhe të qëndrojnë lart format e edukimit kombëtar të fëmijëve tanë. Unë jam njëri prej vullnetarëve në këtë mes, dhe të jesh



Edmond Shkurti gjatë fjalës së hapjes



Dr. Xhemal Kaçuli përshëndet të pranishmit

vullnetar për kombin është një kënaqësi e vërtet për mua," tha ai.

Transmetimin e ndjenjave të pastra dhe të dashurisë së sinqertë për kombin ata nuk e kalonin vetëm nëpërmes kanaleve teorike për tek fëmijët dhe të rinjtë e komunitetit. Nëse të rriturit paguanin \$45 për të shijuar gjithçka të përgatitur për ta, studentët paguanin \$35, e fëmijët vetëm \$25. Një gjë e tillë ua mundësonte edhe atyre që kanë tre apo katër fëmijë, apo atyre që janë akoma në zhvillim e sipër të gjendjes ekonomike, ta sjellin me vete të gjithë familjen për të festuar e gëzuar së bashku.

Shoqata Arbëria gjenë forma të tjera për të mbajtur të hapur llogarinë e saj bankare. Puna e tyre e ndershme gjënë mbështetjen e njerëzve si Besnik Hoxhijaj, një shqiptar i lindur në Amerikë, që punon për departamentin e "Homeland Security." Ai është njëkohësisht edhe pronar i suksesshëm i një kompanie "Real Estate" që në shqip mund të përkthehet afërsisht si "Pronë e Patundshme."

Përveç ndihmës financiare të drejt-

përdrejtë nga vetja e tij, Hoxhijaj e ndihmon shoqatën Arbëria edhe në një mënyrë tjetër: "Unë u bëj telefon pjesëtarëve të familjes dhe miqve kudo që i kam, dhe u them—dëshironi ta ndihmoni komunitetin shqiptar të Houston-it? Ata më thonë se do e bëjnë atë gjë për mua. Kështu, mbas ca ditësh, marr çeçet e tyre, i bej bashkë, dhe ia sjell kryesisht së shoqatës që me to të ndihmojnë veten dhe ata anëtar të komunitetit që kanë më nevojë."

Në këtë mënyrë, kryesia e shoqatës Arbëria kishte marrë përsipër të mbulojë shpenzimet, nëse paratë e mbledhura nga pjesëmarrësit nuk e plotësonin shumën e nevojshme për të paguar lokalitë e bukur të hotelit, darkën, ku me nga një çaj me akull, pije tjetër freskuese, apo një gotë verë (për të rriturit) pjesëmarrësit shoqëronin pjatën e tyre të sallatës, të asaj me mish viçi, patate të pjekura dhe perime të gatuar në avull të nxehtë, për të përfunduar me atë të një pjese nga torta e gatuar veçanërisht për ata.

Po që të mos i ikim konceptit "praktikë," drejtuesit kishin vendosur në



Një kujtim nga festa



Festa i ka bashkuar dhe ky cast fiksohet në fotografi



# ME KRENARI FESTËN E 28 NËNTORIT

njërën anë të skenës flamuri shqiptar dhe atë amerikan në anën tjetër. Midis tyre një parullë të kuqe ku shkruhej me të zeza "Rroftë 28-Nëntori—Dita e Pavarësisë së Popullit Shqiptar." Ndonëse këto përbëjnë shpenzime më të vogla në krahasim me të mësipërmet, për orkestrën nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Këtë herë ata kishin sjellë nga Detroiti grupin e talentuar "Kastrioti," që përbëhej nga muzikantët Përparim Mefaja dhe Erind Emiri. Ata për orë të tëra e elektrizuan sallën me këngët dhe meloditë e bukura, të zgjedhura veçanërisht për këtë festë, nga të gjitha krahinat shqipfolëse. Këngët e tyre shpesh herë shoqëroheshin nga zërat e të rinjve që kërcenin e vallëzonin plot çiltërsi nën tingujt e muzikës që ata prodhonin.

Disa të rinj, të cilët kishin sjellë me vete flamujt e tyre personal, shpesh bëheshin nismëtarë të valleve me karakter patriotik. Kjo gjë kishte tërhequr vëmendjen e historianit Agron Selenica, një nga themeluesit e kësaj shoqate. Ja si u shpreh ai për gazetën Illyria: "Ne shqiptarët e duam shumë flamurin tonë sepse e kemi fituar dhe mbrojtur me shumë sakrificë. Kjo festë që po festojmë sonte, është një dëshmi e gjallë e dashurisë dhe respektit që komunitetit të Houston-it për Atdheun." Në të njëjtën kohë ai shprehu kënaqësinë që shoqata Arbëria e ka fituar kaq rrënjësisht besimin e komunitetit shqiptar të Houston-it.

Ndoshta ky besim ka të bëjë edhe me një fenomen tjetër; ai jepet sepse niveli intelektual i komunitetit është në ato lartësi sa përpjekja për të bërë diçka në të mirë të kombit mbetet reciproke midis anëtarëve të thjeshtë dhe atyre të kryesisë së shoqatës Arbëria.

Sipas disa statistikave jozyrtare, në bazë të popullsisë, komuniteti shqiptar i Houston-it, ka përqindjen më të lartë të të rinjve që vazhdojnë, ose që e kanë mbaruar, shkollën të lartë këtu në Amerikë. Vetëm në këtë festë u identifikuan mbi 12 të rinj si studentë të fushave të ndryshme.

Një prej atyre që i ka përfunduar studimet është Dr. Arian Haxhillari. Ai punon si mjek dhe është në vitin e fundit të rezidencës. Sapo mori vesh se ishin përfaqësues të gazetës Illyria, ai nuk hezitoi të afroi ndihmën e tij për studentët e mjekësisë që mund të vijnë nga Shqipëria dhe që mund të kenë nevojë për orientime në dhënien e provimeve apo të gjetjes së një spitali për të kryer rezidencën. Ai dëshironte




që një ditë të krijonte shoqatën e mjekëve shqiptar në Amerikë. Për këtë ai kishte filluar prej kohësh të shënonte në bllokun e tij të shënimeve emrat e doktorëve shqiptar që kishin shkruar artikuj apo, thjeshtë, kishin reklamuar shërbimet e tyre tek gazeta Illyria.

Për derisa mendjet e ndritura dhe nismëtare të të rinjve shqiptar të Houston-it, vizionet largpamëse të intelektualëve që e udhëheqin këtë komunitet plot jetë e gjallëri sociale, dhe dëshira e të gjithëve së bashku të jetë qëndrimi "Rreth flamurit të përbashkuar / Me një dëshirë e një qëllim," 28 Nëntori do të marrë për vit e më shumë kuptimin dhe seriozitetin që meriton.

Gëzim Laci kishte vënë re se gjatë fjalës së hapjes, mbajtur nga Edmond

Shkurti, kryetar i shoqatës Arbëria, "çdo fjalë e tij ndiqej me një dashuri dhe vëmendje admiruese nga pjesëmarrësit, me një krenari të ligjshme për historinë shumë shekullore të flamurit të kombit tonë."

Megjithatë, Shkurti, me modestinë më të madhe, shprehte respektin dhe dashurinë e tij për të gjithë të tjerët, duke ngritur lart si anëtarët e kryesisë ashtu edhe ata të shoqatës që ai drejton. "Unë," tha ai, "po mundohem të çoj përpara punën e filluar nga paraardhësit e mi. Ndjej vërtet kënaqësi të madhe tek merrem me problemet e shoqatës, sepse duke e bërë këtë merrem njëkohësisht edhe me problemet e kombit shqiptar, si dhe me bashkimin e njohjen e shqiptareve që jetojnë ose vijnë për të jetuar në Houston."



Këngët dhe vallet vazhduan deri në mesnatë



Vallja shqiptare ishte më e preferuara në mbështetjen e flamurit

Pamje nga darka që u shtrua me rastin e Ditës së Pavarësisë, Ditës së Flamurit Kombëtar

The Right Loan For The Right Home.



- Conventional Loans - FHA/VA
- Jumbo Loans - Interest Only Loans
- Refinance - ZERODOWN Loans
- No Documentation Loans
- No Income Verification

Call Today For A FREE Consultation



**Diya Fahs**

Executive Loan Officer - Shore Mortgage  
 Phone: 800-760-3128 Ext. 4807  
 Direct: 313-205-0202

Proudly Serving The Mortgage Needs Of Home Buyers In MI, IL, OH, IN, TN, FL For Over 10 Years

